

QYTETI IM PËR PARATË E MIA RAPORT PËR TRANSPARENCËN E BUXHETEVE LOKALE



*Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga
Ministria e Administratës Publike.*



Ministartvo javne uprave

Titulli i publikimit:

Qyteti im për paratë e mia

(Raport për transparencën
e buxheteve lokale)

Botues:

Instituti Alternativa

Bulevardi Xhorxh Vashington 57,
Podgoricë, Mali i Zi

Tel/Fax: **(+382) 20 268 686**

E-mail: **info@institut-alternativa.org**

Për botuesin:

Stevo Muk

Redaktore:

Milena Muk

Hulumtues:

Naziv Veliq

Bashkëpuntore në hulumtim:

Nikoleta Pavićević and Almedina Dodić

Faqosja dhe dizajni:

Ana Jovović

Podgoricë, shkurt 2019



Ministarstvo javne uprave

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Money Watch: Shoqëria Civile, mbajtësi i buxhetit", i zbatuar nga Instituti Alternativa në bashkëpunim me Institutin për Financa Publike dhe OJQ Horizonti i Ri, me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe bashkëfinancimin e Ministrisë së Administratës Publike. Përmbajtja e Projektit përfaqëson përgjegjësinë e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Administratës Publike.

CIP - КАТАЛОГИЗАЦИЈА У ПУБЛИКАЦИЈИ
НАЦИОНАЛНА БИБЛИОТЕКА ЦРНЕ ГОРЕ, ЦЕТИЊЕ

ISBN 978-9940-533-79-3
COBISS.CG-ID 39197712

PËRMBAJTJA

Hyrja	5
Përmbledhje e rezultateve të transparencës në komuna	7
Andrijevica	7
Tivar	8
Berane	9
Bijello Pole	9
Budva	10
Cetinë	11
Danillovgrad	12
Herceg Novi	13
Guci	13
Kollashin	14
Kotorr	15
Mojkovac	15
Nikshiq	16
Petrnjicë	17
Plavë	17
Plluzhine	18
Plevle	18
Kryeqyteti Podgorica	19
Rozhaje	20
Tivat	21
Ulqin	21
Shavnik	22
Zhablak	23

Transparenca e komunave: shqyrtimet publike për buxhetet lokale	24
Çfarë më pas?	27
Rekomandime	28
Prezantimet në internet të vetëqeverisjeve lokale	29

HYRJE

Raportimi publik dhe disponueshmëria e dokumenteve buxhetore për qytetarët është parakusht për përmirësimin e transparencës së qeverisjeve lokale dhe financave publike të përgjegjshme. Megjithatë, në Mal të Zi këtyre çështjeve, sidomos në nivel lokal, nuk u kushtohet vëmendje e mjaftueshme. Shqyrtimi mbi qeverisjen e mirë në nivel lokal bazohet kryesisht në nevojën për të racionalizuar shpenzimet publike dhe për të optimizuar numrin e të punësuarve, ndërkohë që transparenca e financave publike, si e tillë, shpesh është injoruar në kërkesat zyrtare dërguar komunave në Mal të Zi. Prandaj, në këtë raport, ne përqendrohemi në çështjet themelore të transparencës së financave lokale, duke vlerësuar përmbushjen e standardeve minimale në publikimin e dokumenteve bazë të buxhetit.



Ligji për Qasjen e Lirë në Informata në Nenin 12 parashikon qasje proaktive në informata dhe detyrën e organeve të pushtetit për të publikuar kategori të caktuara të informatave.¹ Ata mund të aplikohen në informatat për financat publike, në një masë më të vogël, me përjashtim të detyrimit të shpallur për të publikuar të gjitha projektligjet dhe aktet e veçanta si dhe kontratat për disponimin e mjeteve financiare nga burimet publike dhe të pasurisë shtetërore.

Megjithatë, një ndryshim në këtë drejtim mund të jetë **zbatimi i Ligjit të ri për Financimin e vetëqeverisjes lokale**. Ky ligj, në përputhje me rekomandimet e Institutit Alternativa (IA), përcaktoi detyrimin për komunat në faqet e tyre të internetit të publikojnë vendimin e buxhetit, vendimin për ndryshimet e buxhetit, vendimin mbi llogarinë përfundimtare të buxhetit dhe raportet tremujore mbi të ardhurat totale të realizuara, shpenzimet e realizuara, detyrimet e papaguara dhe borxhin buxhetorë.² Nga ana tjetër, duke marrë parasysh edhe sugjerimin e IA,³ Planin Nacional i Veprimit për Zbatimin e Iniciativës së Partneritetit për Qeverisje të Hapur në Malin e Zi 2018-2020, përfshinte gjithashtu një masë lidhur me krijimin e një "buxheti për qytetarët", të cilin vetëqeverisjet lokale duhet të përgatisin mbi bazën e modelit

1 / Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata të Malit të Zi, i cili rregullon qasjen e lirë në informata, organi i pushtetit është i obliguar që në faqen e vet të internetit të publikoj informatat në vijim: 1) Udhëzuesin për qasje në informata; 2) Regjistrat publik dhe evidencat publike; 3) Programet dhe planet e punës; 4) Raportet dhe dokumentet e tjera për punën dhe gjendjen në fushat e kompetencës së vet; 5) Draftet, propozimet dhe tekstet përfundimtare të dokumenteve, planeve strategjike dhe të programeve për zbatimin e tyre; 6) Draftet, propozim-ligjet dhe rregulloret tjera, si dhe mendimet e ekspertëve për këto akte; 7) Aktet e posaçme dhe kontratat për mjetet financiare në dispozicion nga të ardhurat publike dhe prona shtetërore; 8) Listën e zyrtarëve dhe nëpunësve shtetëror, me titujt e tyre zyrtarë; 9) Listën e funksionarëve publik dhe listën e llogaritjes së të ardhurave të tyre mujore dhe të ardhurave të tjera, si dhe të kompensimeve lidhur me kryerjen e funksionit publik; 10) Vendimet dhe aktet e tjera të veçanta të cilat janë me rëndësi për të drejtat, detyrimet dhe interesat e personave të tretë; 11) Informatën për të cilën është miratuar qasja sipas kërkesës.

2 / Ligji për financimin e pushtetit lokal (Fleta zyrtare e Malit të Zi, nr. 003/19 nga 15. 1. 2019)

3 / <https://bit.ly/2Wui9bG>

që do të përpilohet nga Bashkësia e Komunave të Malit të Zi. Këto broshura, sipas planit të veprimit, duhet të përdoren gjatë shqyrtimeve publike për buxhetet lokale për vitin 2020 dhe duhet të publikohen në faqet e internetit të njësive të vetëqeverisjes lokale. Me të njëjtin plan parashihet standardizimi i portaleve të internetit të komunave, **përmes standardizimit të udhëzimeve për punimin dhe monitorimin e zbatimit të këtyre udhëzimeve.**⁴

Duke pasur parasysh fillimin e zbatimit të zgjidhjeve të reja ligjore dhe masave strategjike, ky hulumtim bëhet edhe më i rëndësishëm sepse shërben si **një pasqyrë e gjendjes fillestare të transparencës së financave publike lokale**. Me qëllim të paraqitjes së situatës aktuale dhe për të theksuar rëndësinë e publikimit proaktiv të informatave mbi buxhetet lokale, IA në bashkëpunim me OJQ Horizonti i Ri nga Ulqini dhe me mbështetjen e ekspertëve të Institutit të Financave Publike nga Zagrebi, **bëri hulumtime krahasuese dhe analiza të prezantimeve në internet të 23 vetëqeverisjeve lokale në Malin e Zi**. Në mënyrë që të sigurohet kontrolli i cilësisë në procesin e grumbullimit të të dhënave nëpërmjet internetit, kërkimet e web-sajteve sipas kriterëve të përcaktuara më parë, është kryer në dy raunde: në shtator të vitit 2018 janë mbledhur rezultatet paraprake, të cilët janë konfirmuar në dhjetor të vitit 2018. Gjithashtu, në fillim të shkurtit të vitit 2019, të gjitha qeverisjeve lokale të përfshira në sondazh iu është

dërguar drafti i raportit. Përgjigje kemi marrë nga gjashtë vetëqeverisje lokale (Bijello

Pole, Tivar, Ulqin, Rozhajë, Kotorr dhe Podgoricë), e që po ashtu ka kontribuar në kontrollin e cilësisë dhe verifikimin e të dhënave të paraqitura në këtë raport.



Qëllimi i këtij hulumtimi është që përcaktojë se në çfarë mase qytetarët, duke kërkuar faqet e internetit, mund t'i gjejnë këto dokumente: draftin e vendimit të buxhetit të komunës për vitin 2018, vendimin e buxhetit për vitin 2018, vendimin për llogarinë përfundimtare të buxhetit për vitin 2017, raportin gjashtëmujor për realizimin e buxhetit për vitin 2017 dhe udhëzuesin e buxhetit për qytetarët. Për qëllime

të hulumtimit, udhëzuesi i buxhetit për qytetarët nënkupton paraqitjen e dokumenteve të buxhetit në një formë të kuptueshme dhe format të thjeshtë në mënyrë që qytetarët mesatarisht të arsimuar t'i kuptojnë dhe t'i diskutojnë ata. Këto nuk janë hyrje, përmbledhje apo shpjegime që vijnë me dokumentet buxhetore, por një tekst krejtësisht i ri, i thjeshtë dhe i kuptueshëm. Dokumentet kryesore buxhetore që duhet të jenë të paraqitura për qytetarët janë: udhëzimet për buxhetin, propozimi i buxhetit, buxheti i miratuar, ribalancimi, raportet mujore, gjashtëmujore dhe vjetore të realizimit të buxhetit. Gjatë hulumtimit, jemi përqendruar veçanërisht në paraqitjen e draftit dhe vendimit të miratuar të buxhetit në

4 / Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Iniciativës së Partneritetit për Qeverisje të Hapur në Malin e Zi 2018-2020, i qasshëm në: <https://bit.ly/2GyCHKc>

formën e një udhëzuesi për qytetarët, si një kërkesë minimale në këtë drejtim. Po ashtu, kemi vlerësuar nëse dokumentet e kërkuara janë publikuar në një format të lexueshëm - një format që përfshin identifikimin dhe shkarkimin e lehtë të të dhënave buxhetore. Këto dokumente janë përzgjedhur si treguesit kryesorë të transparencës së buxhetit. Hulumtuesit kanë kryer një analizë të hollësishme të faqeve të internetit të komunave duke kërkuar për seksionin "buxheti", seksionin "lajmet", "vendimet dhe kontratat", procesverbalin e seancave të kuvendit të komunave, tabelë së shpalljeve si dhe kërkimin e avancuar të Google. Raporti përmban një pasqyrë të detajuar të rezultateve të anketës sipas komunave dhe, meqë transparenca nuk është një qëllim në vetvete, por hapi i parë dhe themelor drejt përfshirjes më efikase të qytetarëve në vendimmarrjen për buxhetet lokale, **në një seksion të veçantë gjithashtu japim një pasqyrë të pjesëmarrjes së qytetarëve në shqyrtimet publike mbi buxhetet lokale për vitin 2018.** Si bazë për këtë segment të hulumtimit na ka shërbyer analiza e raporteve nga shqyrtimet e mbajtura publike. Së fundmi, duke pasur parasysh periudhën e favorshme të zbatimit të masave të reja strategjike dhe ligjore, ne potencojmë mënyrat e mundshme për përmirësimin e praktikave ekzistuese dhe faqeve të internetit.

PASQYRA E REZULTATEVE TË TRANSPARENCËS SIPAS KOMUNAVE

▪ ANDRIJEVICA

Nga pesë dokumentet e kërkuara buxhetore, në faqen e internetit (<http://opstinaandrijevica.me>) gjenden tre dokumente: Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018, Vendimi i Buxhetit për vitin 2018 dhe Vendimi për llogarinë përfundimtare për vitin 2017. Megjithëse faqja e internetit ka një pjesë të veçantë, të quajtur "buxheti", tek e cila mund të arrihet përmes seksionit "qyteti transparent", këtu nuk gjendet dokumentacioni i plotë buxhetor, por vetëm Vendimi i Buxhetit për vitin 2018, si dhe Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të Komunës për vitin 2017. Këto dokumente gjenden relativisht lehtë, me dy klikime. Gjithashtu, dokumentet në këtë seksion janë të ndara me vite, kështu që gjetja e tyre është e thjeshtë.

Karakteristikë e kësaj vetëqeverisjeje lokale është mungesa e një dokumenti përmbledhës (Drafti i Vendimit të Buxhetit), por ekzistojnë dy dokumente: "Propozimi i planit të shpenzimeve për vitin 2018" dhe "Propozimi i planit të të ardhurave për vitin 2018". Këto dokumente, si dhe thirrja për shqyrtimin publik, mund të gjenden përmes fushës për kërkim në faqen fillestare. Këtu mund të gjendet thirrja për shqyrtimin publik, si dhe propozimet e të ardhurave dhe shpenzimeve. Megjithëse Vendimi i Buxhetit është i disponueshëm në format të lexueshëm, ky nuk është rasti me draftin e këtij vendimi (PDF), as me klasifikimet kryesore të paraqitura në llogarinë përfundimtare të buxhetit (PDF). **Raporti gjashtëmuor i realizimit të buxhetit për vitin 2017, si dhe udhëzuesi i buxhetit për qytetarët, nuk është janë të disponueshëm në faqen e internetit të Komunës së Andrijevicës.**

The Biannual 2017 Budget Execution Report or the Citizens' Guide were not available on the Municipality's web presentation.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Andrijevicës:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (buxheti i qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ **TIVAR**

Ngjashëm me Komunën e Andrijevicës, duke kërkuar faqen zyrtare të Komunës së Tivarit në (<https://bar.me>), qytetarët mund të marrin informacion në tre nga pesë dokumentet e kërkuara buxhetore. Në faqen fillestare ekziston një baner i titulluar "buxheti", që çon në Vendimin e Buxhetit për vitin 2018, si dhe vendime të tjera buxhetore, deri në vitin 2010. Përveç vendimeve, kjo pjesë përmban grafikët që tregojnë buxhetin kapital dhe operativ në përqindje, të çdo viti. Me ngjyrë blu është shënuar buxheti operativ, ndërsa me të gjelbër buxheti kapital. Deri tek llogaria përfundimtare e Buxhetit të Komunës së Tivarit mund të arrihet përmes opsionit Kuvendi i Komunës / Mbledhjet e Kuvendit, si pjesë e materialeve nga mbledhja e tretë e Kuvendit të Komunës së Tivarit. Drafti i Vendimit të Buxhetit për vitin 2018 nuk gjendet me kërkim të seksioneve, por vetëm me kërkimin e avancuar të Google. Prandaj, të tre dokumentet e publikuara të buxhetit janë të publikuara në seksione të ndryshme të web-sajtit, në vend që të bashkohen dhe të jenë lehtësisht të arritshme në kuadër të banerit "Buxheti". Ata nuk janë të lexueshëm nga kompjuteri, sepse janë në dispozicion vetëm në formatin PDF.

Komuna e Tivarit, në faqen e saj zyrtare, nuk i publikon Raportet gjashtëmujore për realizimin e buxhetit dhe Udhëzuesin e Buxhetit për Qytetarët.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të
buxhetit në faqen e internetit të Komunës së Tivarit:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ BERANE

Komuna e Beranës, në faqen zyrtare të internetit (<http://berane.me/>) nuk ka seksion të quajtur "Buxhet", i cili duhet të çojë në dokumentacionin e buxhetit. Vendimi i Miratuar i Komunës për vitin 2018 mund të gjendet duke kërkuar në seksionin "Vendimet, dokumentet", duke zgjedhur nën seksionet "Kuvendi" dhe "Buxheti 2018". Duke kërkuar në faqen e internetit, duke futur fjalë kyçe, mund të gjeni lajmërimi për shqyrtimet publike të buxhetit për vitin 2019, si dhe për vitet 2017 dhe 2016, por jo edhe për vitin 2018. Drafti i Vendimit të Buxhetit për vitin 2018, si dhe Vendimi për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017, u gjetën më kërkimin e avancuar të Google, i cili mbështet faktin se, edhe pse ekzistojnë, ato nuk janë të arritshme për qytetarët që nuk kanë kohë dhe burime të disponueshme për tu informuar detajisht në lidhje me rrjedhën themelore të parave në komunën e tyre. Vendimi i Buxhetit dhe Llogaria Përfundimtare janë të disponueshme në format të lexueshëm (Word), ndërsa Drafti i Vendimit të Buxhetit, i cili është më i rëndësishmi për përfshirjen e qytetarëve, është në dispozicion vetëm në formatin PDF.

Komuna e Beranës gjithashtu, në faqen e saj zyrtare, nuk i publikon Raportet gjashtëmujore për realizimin e buxhetit dhe Udhëzuesin e buxhetit për qytetarët.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Beranës:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ BIJELLO POLE

Në faqen zyrtare të komunës së Bijello Poles, (<https://www.bijelopolje.co.me/>) ekziston baneri "Buxheti", në kuadër të të cilit ndodhen vendimet për buxhetet, të klasifikuara sipas viteve (deri në vitin 2011). Këtu gjithashtu ndodhet Vendimi për Buxhetin e Komunës së Bijello Poles për vitin 2018. Drafti i Vendimit është publikuar edhe në faqen e internetit, por nuk është i arritshëm lehtë sikur Vendimi i miratuar. Nga faqja fillestare si pikënisje, është e nevojshme të përdoren opsionet "qytetarët", "njoftimet", "tabela e shpalljeve", "shqyrtimet publike", pastaj të gjeni linkun "Shqyrtim publik për draftin e vendimit të buxhetit të Komunës së Bijello Poles për vitin 2018", në kuadër të të cilit është publikuar ky dokument PDF, si një shtojcë me një thirrje për shqyrtim publik.

Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Komunës së Bijello Poles për vitin 2017 në kohën e kërkimit nuk ishte i disponueshëm në faqen e internetit, sepse seksioni "Kuvendi"

ishte jashtë funksionit, prandaj ishte e pamundur të arrinim në materialet nga mbledhjet e këtij organi. Në komentet mbi draftin e këtij raporti, komuna e Bijello Poles vuri në dukje se Vendimi për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017 u publikua më 27 dhjetor 2018.⁵ Raporti i Buxhetit Gjashtëmujor për vitin 2017 gjithashtu publikohet në seksionin e buxhetit. Të gjitha dokumentet e publikuara janë të disponueshme vetëm në formatin PDF. Kërkimi gjeti që Komuna e Bijello Poles **nuk ka publikuar Udhëzuesin e Buxhetit për Qytetarët** në lidhje me draftin apo buxhetin e miratuar për vitin 2018, edhe pse në komentet për draftin e raportit thuhej se ky dokument është hartuar për vitin 2019. **Kështu, u botuan katër nga pesë dokumentet e kërkuara.**

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Bijello Poles:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✓
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ BUDVA

Prezantimi zyrtar i Komunës së Budvës (<http://budva.me/>) përmban tre nga pesë dokumentet buxhetore të kërkuara. Në fund të faqes së parë, ekziston baneri "Buxheti për qytetarët", i cili përmban vendime buxhetore, por vetëm me fundin e vitit 2016. Vendimi për Buxhetin e Komunës së Budvës për vitin 2018 mund të gjendet vetëm në kuadër të materialit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, duke kërkuar materialet nga të gjitha mbledhjet, kështu që është më pak i arritshëm sesa vendimet e mëparshme të publikuara në seksionin e veçantë. Në pjesën web-sajtit të titulluar "Shqyrtimet publike", mund të gjenden thirrjet për shqyrtimet publike në lidhje me Draftin e Buxhetit të Komunës, ndërsa si shtesë gjenden edhe Draftet e Vendimeve të Buxhetit për vitet 2019 dhe 2017, por jo për vitin 2018. Për të gjetur Draftin e Vendimit për Buxhetin e Komunës së Budvës për vitin 2018, është e nevojshme që në faqen fillestare të klikoni në "paraqit të gjitha lajmet", dhe pastaj të rishikoni faqet individuale (një faqe përmban 10 artikuj lajmesh). Në kohën e kërkimit, Drafti i Vendimit të Buxhetit për vitin 2018 ishte në faqen e 22-të. Të dy dokumentet e publikuara janë të disponueshëm vetëm në formatin PDF, dmth nuk janë të lexueshëm në kompjuter.

Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit për vitin 2017 nuk mund të gjendet në faqen e internetit të Komunës së Budvës. Pas shqyrtimit të njoftimit të Komunës së Budvës, më 26 qershor 2018, kemi konstatuar se Drafti i Vendimit për Llogarinë Përfundimtare të

⁵ / <http://so.bijelopolje.co.me/index.php/sjednice/usvojene-odluke/133-usvojene-odluke-sa-iii-sjednice>

Komunës së Budvës për vitin 2017, ka qenë në rendin e ditës, më 3 korrik 2018, edhe pse dokumenti nuk është në dispozicion të qytetarëve.

Komuna e Budvës nuk publikon Raporte Gjashtëmuajore për Realizimin e Buxhetit, dhe po ashtu nuk e publikon vazhdimisht Udhëzuesin e Buxhetit për Qytetarët. Kjo qeveri lokale e ka të publikuar Udhëzuesin e Buxhetit për Qytetarë të vitit 2014, deri tek i cili arrihet nëpërmjet banerit në faqen fillestare të sajtit, të titulluar "Udhëzuesi buxhetor". Komuna nuk ka vazhduar praktikën e publikimit të Udhëzuesit në vitet pasardhëse.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Budvës:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✗
Raporti Gjashtëmuajor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ CETINË

Kryeqendra Cetina në faqen zyrtare të internetit (<http://www.cetinje.me/>) nuk u ofron qytetarëve dokumentacionin e buxhetit në një vend. Kategoria "dokumentet" çon në seksionin "buxheti" ku janë publikuar Programi i Debateve Publike dhe Drafti i Vendimit për Buxhetin për vitin 2018.

Megjithëse vendimet buxhetore për vitet e mëparshme janë publikuar ose në seksionin "buxhet" ose në seksionin "vendimet dhe kontratat", Vendimi i Buxhetit për vitin 2018 nuk gjendet këtu. Vendimi për Buxhetin e Kryeqendrës për vitin 2018 është në dispozicion në kuadër të materialeve të diskutuara në mbledhjet e Kuvendit lokal (Kuvendi / Dokumentet). Meqë më shumë se 200 vendime janë publikuar në këtë seksion vetëm për vitin 2018, kërkimi është i vështirë.

Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Kryeqendrës për vitin 2017, është në dispozicion në seksionin "Vendimet dhe Kontratat", dhe mund të arrihet duke klikuar në faqen fillestare në seksionin "Dokumentët", pastaj "Vendimet dhe Kontratat" dhe "Vendimet dhe Kontratat në vitin 2018". Në këtë seksion, ka edhe dokumente të shumta që nuk janë të klasifikuara, kështu që kërkimi është më i vështirë, kurse ky dokument në kohën e kërkimit ishte i 42-ti me rend. Të tre dokumentet e publikuara janë të disponueshëm vetëm në formatin PDF, dhe nuk janë të lexueshëm në kompjuter.

Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët dhe Raporti Gjashtëmuajor për Realizimin e Buxhetit për vitin 2017 nuk është në dispozicion në faqen zyrtare të internetit të Cetinës.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Kryeqendrës Cetinës::**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ **DANILLOVGRAD**

Faqja zyrtare e internetit të Komunës së Danillovgradit (<http://danilovgrad.me/>) nuk përmban një seksion të veçantë me dokumentacionin e buxhetit në faqen fillestare. Vendimi i Miratuar i Buxhetit të Komunës për vitin 2018 është në dispozicion përmes seksionit "Dokumente të rëndësishme", që shfaqet në faqen fillestare të faqes së internetit. Gjithashtu në këtë seksion është një dokument me titull "Buxheti pa vështirësi", i cili përmban një prezantim tabelar të klasifikimit ekonomik të buxhetit të Komunës për vitin 2011 dhe nuk korrespondon me Udhëzuesin e Buxhetit për Qytetarët. Dokumenti që ishte objekt i kërimit - **Udhëzuesi i Buxhetit për vitin 2018, nuk është i disponueshëm në faqen e kësaj vetëqeverisjeje lokale.**

Drafti i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Danillovgradit për vitin 2018 gjendet në seksionin "Aktualitete 2017", i cili shërben për të publikuar lajme të ndryshme, kështu që kërkitimi i dokumenteve është i vështirë. Në mënyrë të ngjashme, Vendimi për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017 është në dispozicion në seksionin "Aktualitete 2018", në kuadër të materialeve të diskutuara në mbledhjet e Kuvendit Lokal dhe po aq i paarrtshëm si dokumenti i mëparshëm. Në kohën e kërimit, njoftimi për vendimet e miratuara në seancën e XXV të Kuvendit (duke përfshirë edhe Vendimin për Llogarinë Përfundimtare të vitit 2017) ishte në vendin e 100 në tabelën e aktualiteteve për vitin 2018. Të tre dokumentet e publikuara janë të disponueshme vetëm në formatin PDF, dhe nuk janë të lexueshëm në kompjuter.

Në faqen e internetit të komunës së Danillovgradit nuk gjendet Raporti Gjashtëmujor për Realizimin e Buxhetit për vitin 2017.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit në
faqen e internetit të Komunës së Danillovgradit:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ HERCEG NOVI

Në faqen fillestare të faqes zyrtare të Komunës së Herceg Novit (<http://www.hercegnovi.me>) gjendet seksioni "Me rëndësi" dhe nënseksioni "Buxheti i komunës". Për të arritur deri tek dokumenti i titulluar "Vendimi për Buxhetin e Komunës së Herceg Novit, për vitin 2018", nevojitet vetëm një klik, por në këtë pjesë të sajtit nuk janë të ofruara dokumente të tjera buxhetore që janë objekt i hulumtimit. Për të arritur deri tek "Drafti i Vendimit të Buxhetit për vitin 2018", ishte e nevojshme të shfletonim 28 faqe në seksionin "Lajmet".

Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Komunës së Herceg Novit mund të arrihet në tre hapa (klikime) nga faqja fillestare, duke kërkuar të vendimet e Kuvendit të Komunës. Të tre dokumentet e publikuara janë të disponueshëm vetëm në formatin PDF, dhe nuk janë të lexueshëm në kompjuter.

Tre dokumentet buxhetore në dispozicion gjenden në seksione të ndryshme të faqes zyrtare të internetit të Komunës së Herceg Novit, **ndërsa dy dokumentet tjera, Raporti Gjashtëmujor për Realizimin e Buxhetit të Komunës dhe Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët nuk janë në dispozicion.**

Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Herceg Novit:

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ GUCIA

Komuna e Gucisë në faqen fillestare të faqes zyrtare të internetit (www.opstinagusinje.me/) tregon buxhetin total për vitin aktual, por seksioni që shpie në dokumentacionin e buxhetit nuk mund të gjendet në këtë faqe. Deri tek seksioni "Buxheti" arrihet përmes seksionit "Shërbimi i qytetarëve", pasuar nga nënseksioni "Qyteti i hapur". Në këtë nënseksion ekziston vetëm një dokument - Vendimi për Buxhetin e Komunës së Gucisë për vitin 2018. Drafti i Vendimit për Buxhetin e vitit 2018 gjendet në nënseksionin "Lajme" (në kohën e kërimit ishte në faqen e 9-të), në kuadër të thirrjes për shqyrtim publik. Ky dokument është i disponueshëm vetëm në formatin PDF, dhe nuk mund të lexohet nga kompjuteri.

Vendimi për Buxhetin Përfundimtar për vitin 2017, Raporti Gjashtëmujor për Realizimin e Buxhetit për vitin 2017 dhe Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët nuk janë në dispozicion. Duhet të theksohet se seksionet "Vendimet e Kuvendit" dhe "Shqyrtime Publike" janë bosh.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Gucisë:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✗
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ **KOLLASHIN**

Vetëqeverisja lokale e Kollashinit, në faqen zyrtare (<http://kolasin.me/>), në kuadër të seksionit "Qyteti i hapur" ka një meny rënëse (drop-down), në të cilën e pesta me radhë ku gjendet opsioni "Buxheti - Llogaria Përfundimtare". Edhe pse ky seksion ekziston, ai nuk është i azhurnuar dhe nuk përmban dokumentet që ishin objekt i kërimit.

Drafti i Vendimit për Buxhetin e Komunës për vitin 2018 është në dispozicion në tabelën e shpalljeve të Komunës, të publikuar më 1 dhjetor 2017 me thirrje për shqyrtimin publik për Draftin e Vendimit të Buxhetit. Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kollashinit për vitin 2018 u publikua në seksionin "Kuvendi i Komunës" në materialet nga seancat. Gjatë hapjes së materialeve të njërës prej mbledhjeve, shfaqen disa dokumente të ngjeshura që ishin objekt i mbledhjes, gjë që e bën më të vështirë qasjen në dokumentin e kërkuar. Vendimi i Buxhetit është i disponueshëm në format të lexueshëm (Word), kurse Drafti i Vendimit në formatin PDF.

Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit të Komunës për vitin 2017, Raporti Gjashtëmujor për Realizimin e Buxhetit për vitin 2017 dhe Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët nuk janë në dispozicion në faqen zyrtare të Komunës së Kollashinit. Prandaj, ky prezantim përmban dy nga pesë dokumentet e kërkuara buxhetore.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Kollashinit:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✗
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ KOTORR

Faqja zyrtare e Komunës së Kotorrit (<http://kotor.me/me>) në faqen fillestare ka një baner "Dokumente", i cili gjithashtu ofron seksionin "Buxheti", por këtu gjendet vetëm Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kotorrit për 2018.

Drafti i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Kotorrit për vitin 2018 është në dispozicion përmes kërkimit të rubrikës "Debatet dhe shpalljet publike", pasuar nga "Debatet dhe thirrjet publike të Sekretariatit për të hyra lokale, buxhet dhe financa". Përfundimisht, duke analizuar përmbajtjen e rubrikës "Shqyrtimi publik për Draftin e Vendimit të Buxhetit të Komunës së Kotorrit për vitin 2018", ku bashkangjitur me një thirrje për shqyrtim publik, gjendet edhe ky dokument buxhetor. Të dy dokumentet e publikuara janë të disponueshëm vetëm në formatin PDF, prandaj nuk janë të lexueshëm në kompjuter.

Tre dokumentet tjera buxhetore: **Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Komunës për vitin 2017, Raporti Gjashtëmujor për Realizimin e Buxhetit për vitin 2017 dhe Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët - nuk janë në dispozicion në faqen e internetit të komunës së Kotorrit.**

Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Kotorrit:

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✗
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ MOJKOVAC

Vendimi për Buxhetin e Komunës së Mojkovacit për vitin 2018 dhe Llogaria Përfundimtare për vitin 2017 u publikuan në kuadër të banerit "Buxheti", i cili shfaqet qartë në faqen fillestare të faqes zyrtare (<https://www.mojkovac.me/>). Na faqën 2/16 të seksionit "Aktualitete", gjatë periudhës së hulumtimit, ishte në dispozicion Drafti i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Mojkovacit për vitin 2018. Njoftimi është postuar nga Sekretariati për Financa, Ekonomi dhe të Hyra Lokale të Komunës së Mojkovacit më 11 prill 2018, dhe dokumenti mund të shkarkohet së bashku me Planin e Shqyrtimit Publik për Draftin e Vendimit të Buxhetit të Komunës. Vendimi i Buxhetit dhe Llogaria Përfundimtare janë në dispozicion në format të lexueshëm (Word), kurse Drafti i Buxhetit, në formatin PDF.

Komuna e Mojkovacit në prezantimin e saj zyrtar në internet, **nuk ka publikuar Raportin Gjashtëmujor për Realizimin e Buxhetit për vitin 2017, si dhe Udhëzuesin e Buxhetit për Qytetarët.** Kështu, janë në dispozicion tre nga pesë dokumentet e kërkuara buxhetore.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit në
faqen e internetit të Komunës së Mojkovacit:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ **NIKSHIQ**

Faqja e internetit të Komunës së Nikshiqit, (<http://niksic.me/>), përmban banerin "Buxheti" i cili çon në dy nga pesë dokumentet e kërkuara buxhetore: Draftin e Vendimit për Buxhetin e Komunës së Nikshiqit për vitin 2018 dhe Vendimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2018.

Edhe pse këto dy dokumente janë të arritshme me një klikim dhe të qasshme për qytetarët, kjo nuk ndodh me Vendimin për Llogarinë Përfundimtare të Komunës së Nikshiqit për vitin 2017. Për tu qasur në këtë dokument, është e nevojshme të klikoni të paktën pesë herë, duke filluar nga faqja fillestare, në: "Administrata Lokale", "Kuvendi i Komunës", "Mbledhjet", dhe pastaj është e nevojshme të kërkonti materialet e secilës mbledhje individualisht. Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit gjendet në materialet e mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Komunës së Nikshiqit, të datës 11 korrik 2018. Është e nevojshme të klikoni mbi titullin, pastaj në materiale, me ç'rast hapet folderi i cili përmban 15 dokumente, ndërsa **Vendimi është i emëruar "Zavrtni rafun" (Llogaria përfundimtare), çka e pamundëson kërkimin e tij në "search" ose kërkimit të avancuar në Google.**

Në mesin e materialeve nga seancat, më saktësisht në materialin për mbledhje e Gjashtë të Kuvendit të Komunës së Nikshiqit, të mbajtur më 18 korrik 2017, ekziston një dokument i titulluar **Raporti për Realizimin e Buxhetit dhe Politikave të Investimeve të Komunës së Nikshiqit për periudhën janar - qershor 2017**. Megjithëse dokumenti ekziston, është e vështirë për qytetarët që të kenë qasje në këtë dokument, sepse është i titulluar: „2.Izvjetaj o izvrtenu Budzeta i investic. politike za jan-jun 2016.god.doc”.

Gjatë hulumtimit të faqes së Komunës së Nikshiqit, **nuk është gjetur Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët**, gjë që çon në përfundimin se katër nga pesë dokumentet e kërkuara të buxhetit janë publikuar në këtë faqe të internetit. Të katër dokumentet që, së bashku me pengesat e përshkruara, janë në dispozicion në faqe, dhe janë të publikuar në format të lexueshëm (Word).

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Nikshiqit:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✓
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ **PETNJICË**

Në faqen fillestare të prezantimit zyrtar të Komunës së Petnjicës (<http://www.petnjica.co.me/>) nuk ka asnjë seksion apo nënseksion me titullin "buxheti", i cili çon në dokumentacionin e buxhetit.

Vendimi për Buxhetin e Komunës për vitin 2018 gjendet në nënseksionin "Vendimet", deri tek i cili arrihet përmes seksionit "Kuvendi", që gjendet në faqen fillestare. Drafti i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Petnjicës për vitin 2018 është i disponueshëm me kërkimin e fjalëve kyçe në faqe fillestare. Të dy dokumentet e publikuara janë të disponueshëm në format të lexueshëm (Word).

Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit të Komunës së Petnjicës për vitin 2017, Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit dhe Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët nuk janë në dispozicion.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit në
faqen e internetit të Komunës së Petnjicës::**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✗
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ **PLAVË**

Në periudhën e hulumtimit dhe përgatitjes së këtij raporti, **faqja zyrtare e Komunës së Plavës nuk ishte në funksion**, gjë që në aspektin e transparencës së buxhetit është komuna më keq e pozicionuar.

▪ PLLUZHINË

Komuna e Plluzhinës, në kuadër të faqes së internetit (<http://www.pluzine.me/>) nuk ka seksion të veçantë të emërtuar "buxheti", i cili çon në dokumentacionin e përmbledhur të buxhetit.

Përmes rubrikave "Të rëndësishme", "Shqyrtimet publike", "Shqyrtimet publike 2015/2016/2017", arrihet deri tek Drafti i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Plluzhinës për vitin 2018, që gjendet si pjesë e thirrjes për shqyrtimin publik. Vendimi për Buxhetin e Komunës së Plluzhinës për vitin 2018 gjendet në nënseksionin "Vendimet për vitin 2018", deri tek i cili arrihet përmes seksioneve "Kuvendi i Komunës" dhe "Vendimet e Kuvendit".

Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Komunës së Plluzhinës u gjet me kërkim të avancuar në Google, por ende nuk mund të përcaktohet se në cilin vend në faqen zyrtare të Komunës, qytetarët mund të arrijnë në dokumentin e buxhetit. Të tre dokumentet e publikuara janë të disponueshëm në format të lexueshëm (Word).

Raporti i Realizimit të Buxhetit Gjashtëmuor dhe Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët nuk janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Plluzhinës.

Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Plluzhinës:

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmuor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ PLEVLA

Shkurtesa "Buxheti" gjendet në faqen fillestare të faqes zyrtare të Komunës së Plevlës (<https://www.pljevlja.me/>), dhe çon në Vendimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2018, si dhe në Vendimin për Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit të Komunës për vitin 2017. Këtu gjenden edhe dokumente të tjera buxhetore, të rreshtuara në mënyrë kronologjike, për vitet e mëparshme, si dhe për vitin e ardhshëm 2019.

Duke kërkuar sajtin, në seksionin "Aktet e Kuvendit" dhe në folderin "Seancat e Kuvendit", arrihet deri tek **Raporti për Realizimin e Buxhetit të Komunës së Plevlës për periudhën e I-VI të vitit 2017**. Drafti i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Plevlës është gjetur me kërkim në opsionin "search" dhe gjendet edhe në seksionin "lajme", i cili megjithatë nuk është në dispozicion në faqen fillestare. Të katër dokumentet e publikuara janë të disponueshëm vetëm në formatin PDF, kështu që ata nuk janë të lexueshëm në kompjuter. **Nuk është në dispozicion Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët.**

Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Plevlës:

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✓
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ **KRYEQYTETI PODGORICA**



Faqja e internetit të Kryeqytetit Podgorica (<http://podgorica.me/>) nuk ofron një opsion kërkimi, përmes të cilit, duke shënuar fjalën do të gjendej edhe dokumentacioni, si dhe nuk ekziston një seksion, baner ose një shkurtesë e quajtur "buxheti" për të ndihmuar qytetarët gjatë kërkimit.

Vendimi për Buxhetin e Kryeqytetit Podgorica për vitin 2018 është në dispozicion në mesin e materialeve të diskutuara në mbledhjet e Kuvendit Lokal, nëpërmjet rubrikës "Kuvendi i Kryeqytetit", pastaj "Aktet e tjera të Kuvendit", "Vendimet" dhe në fund duke klikuar në mbledhjen e XXV, në të cilën është shqyrtuar Vendimi. Drafti i Vendimit për Buxhetin e Kryeqytetit për vitin 2018 nuk është gjetur duke kërkuar në sajt, as në materialet nga mbledhjet dhe njoftimet, por u gjet me kërkim të avancuar.

Për të arritur deri tek dokumenti - Raporti Gjashtëmujor për Realizimin e Buxhetit të Kryeqytetit, duhet që nga faqja fillestare e Kryeqytetit të hapet shkurtesa për nën sajtet e qytetit. Menyja rënëse (drop-down) ofron faqen "Kuvendi i Kryeqytetit". Me klikim arrihet deri tek seksioni "Mbledhjet e Kuvendit - Materialet", pastaj është e nevojshme të klikohet në "Shihni të gjitha", dhe pastaj të hapen materialet e secilës mbledhje individualisht. Në materialet e seancës së XXIII, të datës 28 korrik 2017, e treta me radhë është "Informata për Realizimin e Buxhetit të Kryeqytetit Podgorica për periudhën janar-qershor 2017".

Vendimet e Buxhetit (drafti dhe versioni i miratuar) nuk janë të disponueshëm në format të lexueshëm (PDF), në krahasim me Raportin Gjashtëmujor që është i lexueshëm në kompjuter (Word).

Vendimin për Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit për vitin 2017, Kryeqyteti e ka të publikuar në seksionin "Arkivi". Gjatë kërkimit në faqen zyrtare të Podgoricës gjithashtu

nuk është gjetur Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët për vitin 2018, edhe pse Kryeqyteti e ka hartuar këtë dokument për vitin 2019.

Shfaqja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të kryeqytetit të Podgoricës:

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✓
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ ROZHAJE

Faqja zyrtare e Komunës së Rozhajes (<https://www.rozaje.me/>) në kuadër të titullit "Në shërbimin tuaj", ofron banerin "Buxheti", i cili çon në Draftin e Vendimit për Buxhetin e Komunës së Rozhajes për vitin 2018, të publikuar në formatin PDF.

Ky ishte i vetmi dokument buxhetor i disponueshëm gjatë hulumtimi në web-sajtin e Komunës së Rozhajes, duke përfunduar në dhjetorin e vitit 2018. **Vendimi për Buxhetin e Komunës për vitin 2018, Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit për vitin 2017, Raporti Gjashtëmujor për Realizimin e Buxhetit për vitin 2017, si dhe Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët** nuk ishin në dispozicion gjatë hulumtimit.

Sidoqoftë, në komentet mbi Draftin e Vendimit, i cili iu parashtrua përfaqësuesve të Komunës dhe pasi u theksua se "linku" që duhet të çojë në Vendimin e Miratuar të Buxhetit për vitin 2018 nuk është në funksion, ky lëshim u korrigjua dhe ky dokument i rëndësishëm është publikuar më pas.

Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Rozhajes:

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	I publikuar më pas
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✗
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ TIVAT

Në faqen zyrtare të internetit (<http://opstinativat.com/>). komuna e Tivatit ka publikuar tre nga pesë dokumentet buxhetore të kërkuara. Baneri "Buxheti" çon në Vendimin për Buxhetin e Komunës për të gjitha vitet deri në vitin 2007, duke përfshirë Vendimin për vitin 2018.

Drafti i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Tivatit për vitin 2018 është në dispozicion në seksionin "Shqyrtimet publike 2017", i cili mund të arrihet nëpërmjet banerit "Shqyrtimet publike", në faqen fillestare.

Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit të Komunës së Tivatit për vitin 2017 është në dispozicion në faqen zyrtare dhe gjendet në seksionin "Vendimet e miratuara nga mbledhja e XX e Komunës së Tivatit, të datës 12.06.2018.". Në faqen fillestare, hapet menyuja rënëse (drop-down) "Vetëqeverisja Lokale", e cila ofron nënseksionin "Kuvendi i Komunës". Pastaj, duke klikuar mbi "Vendimet e miratuara në mbledhjet e Kuvendit", arrihet tek opsionet e reja dhe është e nevojshme të përzgjidhet "Përbërja e Kuvendit nga data 11.05.2016.". Deri tek dokumenti i kërkuar arrihet përmes seksionit "Vendimet e miratuara në mbledhje", dhe është e nevojshme të hapen individualisht të gjitha materialet nga mbledhjet për të arritur tek dokumenti i kërkuar, gjë që e bën të vështirë arritjen. Të tre dokumentet e publikuara janë të disponueshëm në format të lexueshëm në kompjuter (Word).

Raporti Gjashtëmujor mbi Realizimin e Buxhetit dhe Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët e Komunës së Tivatit, nuk janë të disponueshëm.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Tivatit:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ ULQIN

Në faqen zyrtare të komunës së Ulqinit (<http://www.opstinaulcinj.com/>) gjendet seksioni "Buxheti", një shkurtesë që çon në një nga pesë dokumentet buxhetore të kërkuara: Vendimi për Buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2018. Ky vendim është i disponueshëm vetëm në formatin PDF, prandaj është i lexueshëm në kompjuter.

Dokumentet të tjera buxhetore që ishin objekt i kërimit web-sajtit të Komunës së Ulqinit (Drafti i Vendimit për Buxhetin e vitit 2018, Vendimi për Llogarinë e Buxhetit Përfundimtar për vitin 2017, Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017 dhe Udhëzuesi i Buxhetit

për Qytetarët) nuk janë në dispozicion në këtë sajt. Ngjashëm me Bijello Polen dhe Podgoricën, edhe Komuna e Ulqinit ka hartuar Udhëzuesin e Buxhetit për Qytetarët për vitin 2019.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✗
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✗
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ **SHAVNIK**

Rubrika "buxheti" në faqen e internetit të Komunës së Shavnikut (<http://www.savnik.me/>) nuk është e dukshme dhe e arritshme për qytetarët, sepse nuk ka seksion apo baner me këtë titull në faqen fillestare, i cili do të shërbente si një shkurtesë për dokumentacionin e buxhetit. Kjo rubrikë është e dukshme vetëm kur hapet menyja rënese e seksionit "Njoftimet dhe informatat". Megjithatë, dokumentet e fundit të publikuara në këtë pjesë të faqes janë nga viti 2015.

Drafti i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Shavnikut për vitin 2018 është në seksionin "Lajmet në faqe - Lajme të tjera" dhe është në dispozicion vetëm pas listimit të faqeve individuale brenda këtij seksioni.

Vendimi për Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit të Komunës së Shavnikut është në dispozicion brenda materialit nga mbledhjet e Kuvendit Lokal, brenda një dosjeje të ngjeshur (zip folder), kështu që është vështirë i arritshëm për qytetarët. Të tre dokumentet e publikuara janë të disponueshëm në format të lexueshëm (Word).

Raporti Gjashtëmujor për Realizimin e Buxhetit të Komunës së Shavnikut për vitin 2017 nuk është në dispozicion në faqen e internetit të Komunës. Nga materiali nga mbledhjet e Kuvendit Lokal, më saktësisht nga Përfundimi për Miratimin e Raportit për Realizimin e Buxhetit të Komunës së Shavnikut për periudhën janar-qershor 2017, del që ky raport është miratuar edhe pse nuk është i disponueshëm në faqen e internetit.

Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët gjithashtu nuk është i disponueshëm në faqen e internetit të Komunës së Shavnikut.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Shavnikut:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

▪ **ZHABLAK**

Gjetja e dokumenteve buxhetore, më saktësisht dokumenteve si: Drafti i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Zhablakut për vitin 2018, Vendimi për Buxhetin e Komunës së Zhablakut për vitin 2018 dhe Llogaria Përfundimtare e Buxhetit për vitin 2017, është mjaft e lehtë në faqen zyrtare (<http://zabljak.me/>) të kësaj vetëqeverisjeje lokale. Të tre dokumentet e publikuara janë në dispozicion në format të lexueshëm (Word, Excel).

Në faqen fillestare ekziston një baner blu i titulluar "buxheti", që çon në tre dokumente të listuara, si dhe në dokumentacionin e buxhetit për vitet e mëparshme. Megjithatë, Raporti Gjashtëmujor për Realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2017 dhe Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët nuk janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Zhablakut.

**Paraqitja tabelare e dokumenteve të kërkuara të buxhetit
në faqen e internetit të Komunës së Zhablakut:**

Drafti i Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) i Buxhetit për vitin 2018	✓
Vendimi (i miratuar) për Llogarinë Përfundimtare për vitin 2017	✓
Raporti Gjashtëmujor i Realizimit të Buxhetit për vitin 2017	✗
Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët (Buxheti i Qytetarëve) për vitin 2018	✗

TRANSPARENCA E KOMUNAVE: SHQYRTIMET PUBLIKE PËR BUXHETET LOKALE

Transparenca nuk është një qëllim në vetvete. Hapja e dokumenteve, duke i publikuar ato, është hapi i parë dhe i domosdoshëm që publiku të përfshihet në vendimmarrje dhe në shqyrtimin e prioriteteve të rëndësishme lokale. Prandaj, në këtë pjesë, fokusohemi në praktikën e organizimit të shqyrtimeve publike për buxhetet lokale, bazuar në raportet nga shqyrtimet publike për draftet e vendimeve të buxhetit lokal për vitin 2018.

Ndryshe nga niveli qendror, ku Ministria e Financave është liruar nga obligimi për të organizuar shqyrtim publik për buxhetin e shtetit, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale në mënyrë eksplicite obligon komunat, që përpara miratimit të buxhetit, të organizojnë shqyrtime publike që do zgjasin për të paktën 15 ditë.⁶ Të gjitha komunat kanë zbatuar këtë detyrim në lidhje me buxhetet lokale për vitin 2018.

Megjithëse shtatë komuna nuk raportojnë me saktësi për pjesëmarrjen e qytetarëve në shqyrtimet publike për buxhetet e tyre (Budva, Tivati, Herceg Novi, Plevla, Plluzhinë, Andrijevica dhe Gucia), të dhënat në dispozicion tregojnë se qytetarët kryesisht nuk ishin të përfshirë në shqyrtimet për buxhetin për vitin 2018. Vetëm Komuna e Tivarit dallon, ku ka pasur 174 pjesëmarrës në shqyrtimet publike të mbajtura në bashkësi të ndryshme lokale. Nga ana tjetër, nga raportet e disponueshme rezulton se në shqyrtimet publike për buxhetet lokale për vitin 2018, nuk kishte fare qytetarë në Podgoricë, Cetinë, Petnjicë dhe Shavnik.

Komunat shpesh në raporte kanë konstatuar se ka pak interes për të marrë pjesë në shqyrtimet publike. Sidoqoftë, nga ana tjetër, siç ka treguar ky hulumtim, nuk janë bërë përpjekje për të sqaruar kategoritë bazë të buxhetit për qytetarët dhe as kanë qenë mjaft proaktiv për të publikuar dokumentet kryesore të buxhetit në një format më të qasshëm.

6 / Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (Fleta Zyrtare e Malit të Zi nr 002/18 në 10. I. 2018.)

Pasqyra tabelare e shqyrtimeve publike për buxhetet lokale për vitin 2018:

KOMUNA	NUMRI I QYTETARËVE NË SHQYRTIM
PETNJICA	Janë mbajtur tre shqyrtime publike, një për qytetarët dhe përfaqësuesit e bashkësive lokale, një shqyrtim tjetër publik për ndërmarrjet dhe OJQ-të (nuk ka pasur interesim) dhe i treti për partitë politike.
TIVAR	BL Merkoti - 25 pjesëmarrës, 12 marrin pjesë në shqyrtim; BL Spiç - 26 pjesëmarrës, 12 marrin pjesë në shqyrtim; BL Ostros dhe Shestan - 44 pjesëmarrës, 4 marrin pjesë në shqyrtim, BL Crmnica - 7 pjesëmarrës, 4 marrin pjesë në shqyrtim; BL Tivar I, II, III, IV, V, Shushanj dhe Tivari i vjetër - 72 pjesëmarrës, 25 marrin pjesë në shqyrtim.
HERCEG NOVI	Numri i pjesëmarrësve nuk është përcaktuar saktësisht, është konstatuar se në shqyrtime morën pjesë anëtarët e këshillit të BL dhe një numër i vogël qytetarësh.
KOLLASHIN	Numri i pjesëmarrësve nuk është specifikuar.
ANDRIJEVICA	U mbajtën dy shqyrtime publike, i pari për përfaqësuesit e bashkësive lokale dhe qytetarë (morën pjesë 10 përfaqësues të BL dhe disa qytetarë) dhe tjetri për përfaqësuesit e institucioneve publike, organizatat joqeveritare, partitë politike dhe shoqatat sportive.
BERANE	Numri i pjesëmarrësve nuk është specifikuar. Janë mbajtur gjithsej katër shqyrtime: 1) për ndërmarrësit dhe sipërmarrësit, 2) për bashkësitë lokale, sindikatat dhe qytetarët, 3) për sektorin joqeveritar dhe 4) për partitë politike.
BIJELLO POLE	Në fund të vitit 2017, u miratua vendimi për financimin e përkohshëm të Komunës së Bijello Poles.
CETINË	Raporti thekson se qytetarët nuk kanë shprehur interesim për të marrë pjesë në shqyrtimin publik.
DANILOVGRAD	Numri i pjesëmarrësve nuk është specifikuar.
KOTORR	Numri i pjesëmarrësve nuk është specifikuar.
MOJKOVAC	Numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë në shqyrtim nuk është saktësisht i shprehur. Theksohet se janë ndërmarrë masa për të nxitur qytetarët, por edhe krahas kësaj, interesimi ishte i vogël. Në shqyrtim morën pjesë përfaqësues të partive politike, organizatave sportive, bashkësive lokale dhe individë. Është mbajtur edhe një shqyrtim, ku morën pjesë përfaqësuesit e tre bashkësive lokale, por numri i saktë i pjesëmarrësve nuk është publikuar.

KOMUNA	NUMRI I QYTETARËVE NË SHQYRTIM
NIKSHIQ	Përveç hartuesit të draftit dhe mediave, vetëm dy qytetarë kanë marrë pjesë në shqyrtim.
PLLUZHINE	Numri i pjesëmarrësve nuk është specifikuar.
PLJEVLA	Janë mbajtur tre shqyrtime publike: i pari me përfaqësuesit e këshillave të bashkësive lokale urbane, shqyrtimi i dytë me përfaqësuesit e bashkësive lokale rurale dhe i treti me klubin e anëtarëve të Partisë Demokratike të Socialistëve në pushtet. Nuk dihet se sa qytetarë morën pjesë në shqyrtime.
PODGORICA	Në raport është konstatuar se qytetarët nuk treguan interes për pjesëmarrje në shqyrtimin publik qendror.
ROZHAJE	Numri i pjesëmarrësve nuk u përcaktua saktësisht, në shqyrtim morën pjesë një "numër i caktuar" i qytetarëve, përfaqësues të OJQ-ve, këshilltarë lokalë dhe përfaqësues të medias.
SHAVNIK	Është konstatuar se nuk ka pasur pjesëmarrës të interesuar.
TIVAT	Nuk është specifikuar numri i saktë i qytetarëve të cilët ishin të pranishëm në shqyrtimin publik për përfaqësuesit e bashkësive lokale dhe qytetarë.
ZHABLAK	15 persona morën pjesë në „tubim“.
ULQIN	Janë organizuar gjithsej tre shqyrtime. Nuk është specifikuar numri i pjesëmarrësve që morën pjesë në shqyrtimin e parë, në të dytin nuk kishte pjesëmarrës për shkak të kohës jo të mirë, ndërsa në shqyrtimin e tretë ishin 10 qytetarë të interesuar.
GUCI	Të pranishëm ishin 22 pjesëmarrës.
BUDVA	Numri i pjesëmarrësve nuk është specifikuar.
PLAVË	U mbajtën dy shqyrtime publike, ku morën pjesë gjithsej 24 pjesëmarrës.

ÇFARË MË PAS?

Nga dokumentet e kërkuara, më të publikuar janë vendimet e buxhetit (drafti dhe versioni i miratuar), ndërsa gjatë periudhës së hulumtimit (2017 dhe 2018) asnjë komunë nuk publikoi të ashtuquajturin "Buxheti për qytetarët". Duke pasur parasysh rëndësinë e Llogarisë Përfundimtare të Buxhetit, si një dokument i cili ndër të tjera duhet të tregojë të gjitha devijimet e shpenzimeve të realizuar nga plani për atë vit dhe raportin për projektet kapitale,⁷ është shqetësues fakti se **15 nga 23 komunit, kanë publikuar Vendimin e Miratuar për Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit Lokal**. Kjo do të thotë se qytetarët përmes web-sajteve të komunave Budva, Guci, Kolashin, Kotorr, Petnjicë, Plavë, Rozhaje dhe Ulqin nuk kishin mundësi të merrnin informacion të plotë për Realizimin e Buxhetit Lokal për vitin 2017.

Edhe pse dokumentacioni i kërkuar është publikuar në faqet e internetit të komunave, ai shpesh gjendet në seksione që janë "të largëta" nga faqja fillestare, të pasakta, me emra dhe shkronja të gabuara që e bëjnë të vështirë gjetjen. Shembulli më ilustrues është ai i Komunës së Nikshiqit, e cila edhe pse ka publikuar Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit për vitin 2017, ata e kanë titulluar atë „Zavrtni rafun”. Gjithashtu, shumica e dokumenteve të publikuara nuk janë të disponueshëm në format të lexueshëm kompjuterik, por më shpesh në formën e dokumenteve PDF, të cilat nuk lejojnë kërkimin dhe shkarkimin e linjave buxhetore që janë me interes të veçantë për grupe të caktuara të qytetarëve. Prandaj, **publikimi i thjeshtë i materialeve, nëse nuk ka vullnet për ta bërë atë në një mënyrë të arritshme për qytetarët, nuk është i mjaftueshëm për të krijuar një nivel të kënaqshëm të transparencës**.

Më keq e vlerësuar është komuna e Plavës, e cila nuk kishte një faqe interneti funksionale gjatë periudhës së hulumtimit, duke lënë qytetarët e kësaj komune në përgjithësi pa një "informator" zyrtar për punën e vetëqeverisjes së tyre lokale, përfshirë këtu financat publike. **Komuna e Ulqinit, e cila ka vetëm Vendimin e Miratuar të Buxhetit për vitin 2018, ndan me qytetarët e vet pak informata për financat publike.**

Ekzistenca e një seksioni të veçantë të buxhetit në faqet e internetit është më shpesh konfuze, sepse jo të gjitha informatat kryesore të buxhetit janë vendosur atje. Megjithatë ekzistenca e një seksioni të tillë dhe e banerit në faqen e parë të internetit është e justifikueshme, vetëm mund të komplikojë gjetjen e informatave kyçe.

Të dhënat tregojnë se qytetarët kryesisht nuk morën pjesë në shqyrtimet publike të buxhetit. Megjithatë, një nga arsyet për përfshirjen e dobët të qytetarëve është mungesa e vullnetit të vetëqeverisjeve lokale për informimin në mënyrë proaktive të qytetarëve të vet për financat publike. Këtë e tregoj edhe ky raport përmes mungesës së plotë të prezantimit të buxhetit në një format të përshatshëm për qytetarët dhe përmes publikimit të pamjaftueshëm të informatave për Realizimin e Buxhetit. **Katër komunit e vetme që publikuan Raportin për**

7 / Ligji për Buxhet dhe Përgjegjësi Fiskale (Fleta zyrtare e Malit të Zi nr 020/14 e 25. 5. 2014; 056/14 od 24. 12. 2014; 070/17 e 27. 10. 2017; 004/18 e 26. 1. 2018; 055/18 e 1. 8. 2018)

Realizimin e Buxhetit gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2017 janë: Bijello Pole, Nikshiqi, Plevla dhe Podgorica, gjë që mund të përbëjë sfidë në zbatimin e detyrimeve të reja të parapara me Ligjin për Financimin e Vetëqeverisjes Lokale.

REKOMANDIME

- Udhëzimet për krijimin e portalit të internetit të vetëqeverisjeve lokale duhet të përfshijnë detyrimin për të paraqitur dhe për të shfaqur qartë seksionet e buxheteve në faqet fillestare të web-sajteve, të cilët do të përmbajnë të gjitha dokumentet kryesore të buxhetit, duke përfshirë draftin dhe vendimin e miratuar për buxhetin lokal, raportet për realizimin e buxhetit që komunat janë të obliguara të publikojnë gjatë vitit, llogarinë përfundimtare të buxhetit lokal dhe buxhetin për qytetarët;
- Përveç draftit të vendimeve për buxhetet lokale, të cilat jepen në shqyrtim publik, vetëqeverisjet lokale duhet të përpiqen që dokumentet tjera të rëndësishme buxhetore, duke përfshirë raportet tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për realizimin e buxhetit dhe vendimet e miratuara të buxhetit, t'i publikojnë në formën e "buxheti për qytetarët";
- Të gjitha raportet dhe dokumentet buxhetore duhet të jenë të disponueshme në format të lexueshëm kompjuterik, në mënyrë që qytetarët të mund të njihen lehtësisht me kategoritë buxhetore për të cilat ata janë më të interesuar.



FAQET E INTERNETIT TË QEVERIVE LOKALE:

- Faqja zyrtare e Komunës së Andrijevicës – <http://opstinaandrijevica.me>
- Faqja zyrtare e Komunës së Tivarit – <https://bar.me>
- Faqja zyrtare e Komunës së Beranes – <http://berane.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Bijello Poles – <https://www.bijelopolje.co.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Budvës – <http://budva.me/>
- Faqja zyrtare e Kryeqendrës Cetinë – <http://www.cetinje.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Danillovgrad – <http://danilovgrad.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Herceg Novit – <http://www.hercegnovi.me>
- Faqja zyrtare e Komunës së Gucisë – www.opstinagusinje.me/
- Faqja zyrtare e Komunës së Kollashinit – <http://kolasin.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Kotorrit – <http://kotor.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Mojkovacit – <https://www.mojkovac.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Nikshiqit – <http://niksic.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Petnjicës – <http://www.petnjica.co.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Pluzhinës – <http://www.pluzine.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Plevlës – <https://www.pljevlja.me/>
- Faqja zyrtare e Kryeqytetit Podgorica – <http://podgorica.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Rozhajës – <https://www.rozaje.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Tivatit – <http://opstinativat.com/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Ulqinit – <http://www.opstinaulcinj.com/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Shavnikut – <http://www.savnik.me/>
- Faqja zyrtare e Komunës së Zhablakut – <http://zabljak.me/>